

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tmerri i 40-vjeçares në Vlorë/ Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet
ADRESA	https://piranjat.al/investigime/tmerri-i-40-vjecares-ne-vlore-si-u-shnderrua-njohja-e-re-ne-perndjek-i104933
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 20:35:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 20:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1d17e6302ca60919a142f2a2dc5b87f0522e2b5d627312d4b2b1432d4b791529
TEKSTI	ea7d4ffbb55e8a6b4d8e8fb0fddf0cd16809ab8de18d4bb009569355ec5a8451
PAMJA	4c27ff23f13e48ed1d20b144d9c7e51d35fa9eb10c96800490deaa392e0af137

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	979b1946805a528875f2318e0959d3e839fcd0353bf2e2797c1dd296c5d205f0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/979b1946805a528875f2318e0959d3e839fcd0353bf2e2797c1dd296c5d205f0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash: në **përndjekje**, imagjinatës. Se unë, kur **vendimit** të konstatuar përplasja e drama që Hage, as në **Beograd** Chrintare të Kosovës ka një **edhe për trajtimin e** e Triportit në Vlorë, **diplomës rezulton** ministres së Shëndetësisë. E cilësuar ... **i nj që**

INVESTIGIME

Tmerri i 40-vjeçares në Vlorë/ Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 22:25



Historia që do t'ju tregojmë kalon çdo kufij të imagjinatës. Se unë, kur e plas bombën, e plas. Çfarë mund ta shtyjë një person drejt një agresiviteti të tillë, sa të kërcënojë se do të plasë një bombë që ta marrë vesh i gjithë pallati? Për ta marrë vesh këtë, na duhet të udhëtojmë drejt Vlorës, ku takohemi me një zonjë rreth të 40-tave, e cila ka pësuar jo pak nga ky individ që duket se ka dalë tërësisht jashtë kontrollit.

Zonja ka shumë vite që ka lënë pas një martesë dhe ka rinisur jetën duke rritur e vetme 3 fëmijët e saj.

Vitet kalojnë dhe, në një moment kur ndjehet më e sigurt, ajo vendos se ka ardhur momenti të krijojë një lidhje të re. Me një person që, fatkeqësisht, nuk ishte aq i pranishëm në jetën e saj.

Por shumë shpejt gruaja vëren një sjellje aspak normale që e fut në dyshime serioze. Në këto kushte, duke marrë parasysh që ende mes të dyve gjërat nuk ishin bërë serioze, vendos të shkëputet nga kjo marrëdhënie. Por kjo, me sa duket, ishte si një qetësi përpara stuhisë, sepse shumë shpejt gjërat marrin një rrugë të paimagjinueshme dhe, për zonjën, do të ishte fillimi i tmerrit.

Zonja tregon për Piranjat që zotëria nisi ta përndiqte si virtualisht, ashtu edhe fizikisht.

Por, me shpresën që ky i fundit do të largohej, kjo e fundit nuk e denoncon.

Një gabim që zonja, në një rast tjetër, nuk do ta përsëriste...

Për më tepër, kur shikonte se presionet dhe kërcënimet sa vinin e shtoheshin, deri aty sa i shkruante miqve dhe të afërmeve të 40-vjeçares. Pas këtij veprimi flagrant, dukej se ky përndjekës i rrezikshëm i kishte plotësuar kushtet që të përballë me drejtësinë, ku policia e Rinasit e ndaloi këtë të fundit. Pra, një burrë me njëfarë moshe, i cili sapo ka njohur një grua, por acarohet kur sheh që ajo nuk e pranon në jetën e saj.

Madje bëhet agresiv, sa që e detyron 40-vjeçaren t'i drejtohet policisë.

Mund të ngjajë e pabesueshme, por jemi përpara një situatë të cilën ende askush nuk arrin ta zgjidhë, për më tepër kur në përndjekjen e gruas janë përfshirë edhe persona të panjohur për këtë të fundit. Zonja tregon se Eduardi dërgonte njerëz të paguar për ta ndjekur atë dhe fëmijët e saj kudo që shkonte. Një përndjekje në kohë reale dhe me shumë aktorë, që do të duhej të vinte në lëvizje organet ligjzbatuese, por që, me të gjitha faktet, gjykata vendosi ta lërë në masën detyrim paraqitje.

Nuk mund ta dimë nëse kjo siguri vjen nga deliri i këtij individ, apo nga lidhjet e forta që ai pretendon se ka në polici... Dhe këtë siguri të një personi të paprekshëm, ai ia shpreh në çdo moment gruas që shantazhon çdo ditë. Në situatën kur tonet ngrihen dhe presioni bëhet më i madh, 52-vjeçari nis të shantazhojë nëpërmjet familjarëve.

Përndjekja dhe shantazhi ishin një tentativë për të arritur qëllimin dhe, kur kjo nuk arrihet, strategjia ndryshon.

Siç ndodh shpesh me përndjekësit serialë, arma e tyre e fortë është denigrimi i viktimave në rrjetet sociale. Dhe Eduardi nuk mund të bënte përjashtim. Në këto kushte, gruaja drejtohet edhe njëherë në polici, kësaj radhe për të denoncuar denigrimin që po pëson në rrjetet sociale nga ky individ.


Që, siç mund të imagjinohet, doli edhe njëherë jashtë kontrollit.

52-vjeçari duket tepër i fiksuar ndaj teknologjisë dhe regjistrimit të bisedave. Por edhe i drejtpërdrejtë në kërcënimet e tij. Kjo situatë e përsëritur ka shkaktuar një gjendje të rënduar psikologjike te 40-vjeçarja, e cila është trajtuar me mjek specialist. Situata vazhonte e rëndohej dhe, në të tilla kushte, zonja drejtohet sërish në Komisaratin e Vlorës për denoncimin e radhës, dosja e cila dërgohet në Prokurorinë e Vlorës.

Në kemi udhëtuar më shumë se 4 herë në Vlorë për të gjetur vendndodhjen e Eduardit, por ky i fundit qëndronte në Itali, edhe pse do duhej të paraqitej në prokurori për masën e tij të sigurisë. Ndaj, kur jemi të sigurt që Eduardi do të vinte në Vlorë, së bashku me policinë e këtij qyteti dhe me bashkëpunimin e Prokurorisë Vlorë, bëhet e mundur ndalimi dhe arrestimi i Eduard Limajt. **Piranjat news**

"Në çdo vend të Europës plagjiatura është mashtrim, veç për penale, dhe në Shqipëri personazhe të tillë jo vetëm që duhet të kishin dhënë dorëheqjen dhe të ishin larguar nga jeta publike, por

duhet të ishin merrtë masat që kështu personave t'u ishin siguruar udhë, të kishin kuptuar përmasat që kanë marrë për shkak të kështu udhës dhe të ishin krijuar të gjitha rregullimet udhë për
legjislative që këto fenomene të parandaloheshin", përfundon studiuesi Muka./piranjat news



Artikuj te sugjeruar

INVESTIGIME 18 Shtator22:05

[Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës](#)

Në shumë raste, ndarja e një çifti me fëmijë të mitur shoqërohet me konflikte, përplasje e drama që godasi...

INVESTIGIME 18 Shtator21:39

[TEC-et lundruese dhe mbetjet e rrezikshme/ KESH paguan edhe për trajtimin e mbetjeve të “Tigrave”](#)

Dy TEC-et lundruese “Tigri 1” dhe “Tigri 3”, të ankoruara në zonën e Triportit në Vlorë, nuk kanë qenë...

INVESTIGIME 18 Shtator21:26

[“Ministrja kopjace”/ Klodiana Spahiu në krye të Shëndetësisë, punimi i diplomës rezulton plagjiaturë](#)

Të mërkurën e 2 shtatorit 2026, zonja Evis Sala dha dorëheqjen nga posti i ministres së Shëndetësisë. E cilësuar ...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

INVESTIGIME 31 Maj13:33

[Gratteri për Piranjat: Mafia shqiptare ortake me Ndrangheta kalabreze](#)

Në intervistën për Piranjat, Nicola Gratteri paralajmëron se mafia shqiptare po forcon pozitat e saj në Europë, veçan&eum...

INVESTIGIME 31 Maj13:12

[Gratteri për Piranjat: Kullat në Tiranë tregues i riciklimit](#)

Kryeprokurori italian i antimafias, Nicola Gratteri, në një intervistë ekskluzive për Piranjat, ngre dyshime të forta mbi burimin e i...

INVESTIGIME 31 Maj10:50

[Katër nëna në kërkim të fëmijeve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët](#)

Prej tre javesh Piranjat kane sjeite rretimn e 4 nenave nga qyteti i Durrësit te ciat te alarmuara kerkonin kthimi...

INVESTIGIME 31 Maj10:26

[Flamur Gjuzi, i dënuar për "shpërdorim detyre" sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?](#)

Një javë më parë "Piranjat" publikuan historinë e 54-vjeçarit dibran, Fatmir Lakushi, i cili në vitin...

INVESTIGIME 31 Maj10:05

[Pallatet u zhytën "Durrës Marina" dhe Autoriteti Portual bëjnë veprimin e papritur përballë skandalit](#)

Skandali i zhytjes së pallateve në projektin "Durrës Marina" po thellohet çdo ditë e më shumë. Pas publikimit...

INVESTIGIME 31 Maj09:46

[Ekskluzive/ Nicola Gratteri çmonton skemën e pastrimit të parave të ndërtimit në Tiranë](#)

Bumi i ndërtimeve dhe ngritja e pandalshme e kullave në Tiranë kanë ngritur prej kohësh pikëpyetje mbi burimin e financimeve dhe...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 18 Shtator

["Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la"...](#)

Loer Kume, deputet i Partisë Socialiste për Durrësin dhe prozator e eseist i njohur, ka njoftuar mesditën e kësaj të premte ndar...

BOTA 18 Shtator

[Trump: Ka pasur përparim të madh drejt bazës us...](#)

Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, deklaroi të enjten se ka pasur "përparim të madh" drejt krijimit të një baze ush...

BOTA 18 Shtator

[Ngjarje e rëndë në aeroport, avioni përfshihet ...](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Libi, ku një avion i cili sapo ishte ulur, u përfshi nga flakët. Avioni privat Cessna Ci...

INVESTIGIME 18 Shtator22:25

[Tmerri i 40-vjeçares në Vlorë/ Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet](#)

Historia që do t'ju tregojmë kalon çdo kufij të imagjinatës. Se unë, kur e plas bombën, e plas. Çfarë...

video




TEC-et lundruese dhe mbetjet e rrezikshme/ KESH paguan edhe për trajtimin e mbetjeve të “Tigrave”



TEC-et lundruese dhe mbetjet e rrezikshme/ KESH paguan edhe për trajtimin e mbetjeve të “Tigrave”





Liria nuk burgoset, as në Hagë, as në Beograd



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.